

V E N D I M
Nr.554, datë 2.12.1999

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I SEKSIONIT RRUGOR MILOT LEZHË, TË KORRIDORIT
VERI-JUG**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 dhe 9 të ligjit nr.7848, datë 25.7.1994 “Për shpronësimin për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive të paluajtshme”, me propozimin e Ministrisë së Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i seksionit rrugor Milot-Lezhë, të korridorit Veri-Jug, pronë e personave të shënuar në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, të cilët shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas listës emërore dhe sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për shumën e përgjithshme prej 47 054 144 (dyzeteshtatë milionë e pesëdhjetekatër mijë e njëqindedyzetekatër) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga fondi i miratuar për këtë objekt, në buxhetin e vitit 1999, për Ministrinë e Transportit, në zërin “Shpronësime”

5. Shpronësimi të përfundojë brenda vitit 1999.

6. Ngarkohen Ministria e Transportit, Ministria e Pushtetit Lokal, Këshilli i Rrethit të Lezhës dhe komunat përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta